



# Informata për prindë me rastin e fillimit të shkollës fillore

*Të dashur prindë*

*Pas vijimit të Kopshtit të fëmijëve para fëmiut të juaj qendron hyrja në shkollën fillore. Me siguri kjo pritet me padurim për juve dhe fëmiun e juaj. Sikurse të çdo ndryshim edhe këtu paraqiten probleme, ka pasiguri por edhe dyshime. A është i pjekur fëmiu im për shkollë? A mund t' a përballojë situatën e re?*

*Kjo broshurë ka për qëllim që t' ua mundësojë disa informata themelore për shkollimin.*

DEPARTAMENTI I EDUKIMIT  
I KANTONIT ST. GALLEN  
Dikasteri për shkollë popullore  
Davidstrasse 31  
9001 St.Gallen

Qershor 2003

## Aftësitë për shkollë

Sigurisht për ju si prindë çështja e aftësive shkollore ka një rëndësi të jashtzakonshme. A është i gatshëm për shkollë fëmiu im? A mund t' i plotësoj kërkesat e parashtruara? A duhet t' a vijojë klasën e parë dyvjeçare apo t' a filloj shkollën më herët?

Koncepti i aftësive shkollore në vitet e fundit ka ndryshuar shumë. Ajo që deri para disa vitesh është thënë si „pjekuri shkollore“ dhe që është paraqitur për gjendjen e zhvillimit personal të secili fëmi nuk vlen më, sot nisemi nga ajo se „aftësitë shkollore“ nuk varen vetem prej një tipari, por ato varen prej shumë lëmive.

*Gjendja e zhvillimit dhe aftësive të fëmiut*

Secili fëmijë është i veçant. Ka përparësi, aftësi dhe prirje të ndryshme. Zhvillimi i tij rrjedh individualisht.

*Kushtet për mësim dhe kërkesat e shkollës*

Shkolla paraqet kërkesat e caktuara për fëmijë. Këto janë të lidhura me planin mësimor dhe me organizimin e shkollës. Kërkesat për mësim varen edhe nga përbërja e

nxënësve në klasë, numri i nxënësve në klasë dhe ofertat e ndryshme për ndihmë e nxitje në mësim.

### *Sfondi familjarë*

Fëmijtë rriten në familje të ndryshme dhe krijojnë përvoja të ndryshme.

Aftësitë shkollore nuk janë madhësi absolute, ato mund të maten. Në Kopshtin e fëmijëve përdoren forma të shumëllojshme të vlerësimit e të vërejturit. Në qendër të këtyre vlerësimeve qendron biseda në mes juve si prindë dhe edukatores. Nëqoftëse në mes prindërve dhe edukatores nuk arrihet vlerësimi i kuartë, mendimi i njejtë, ka në dispozicion persona të ndryshëm profesional (përgjegjës për arsim, pedagogët shkollor, shërbimi psikologjik shkollor etj.).

## **Format e shkollimit**

Prindërit dhe edukatorët e Kopshtit të fëmijëve, të fëmijtë e moshës shkollore, vërejnë ndryshime të mëdha në zhvillimin individual të tyre. Për t' i marrë parasysh këto ndryshime ekzistojnë format e ndryshme të shkollimit.

### *Shkollimi i rregullt*

Për fëmijtë, të cilët me 1. gusht plotësojnë moshën 6 vjeçare, fillon obligimi shkollor dhe pas pushimeve verore sipas rregullit fillojnë klasën e parë të shkollës fillore.

### *Klasa e parë dyvjeçare (Einführungsklasse)*

Fëmijtë, të cilët në moshën e fillimit të shkollës janë pjesërisht të aftë, vijojnë klasën e parë dyvjeçare. Klasa e parë dyvjeçare zgjatë dy vite dhe numri i nxënësve në këto klasë është prej 10 deri 15. Temat e klasës së parë të shkollës fillore janë të ndara në dy vite shkollore. Nxënësit pastaj kalojnë në klasën e dytë të shkollës fillore. Në disa komuna shkollore organizohen edhe forma speciale, si psh. viti parapërgatitor shkollor.

### *Shkollimi i parakohëshëm*

Fëmijtë, të cilët para moshës së rregullt për fillimin e shkollës janë të aftë për shkollë, mund të fillojnë shkollën më herët.

Propozimin e bën edukatorja e Kopshtit të fëmijëve apo Shërbimi shkollor psikologjik me pëlqimin e prindërve.

### *Shtyerja e obligimit shkollor*

Në rastet e jashtëzakonshme, fëmijtë ende të paaftë për shkollë, vijojnë edhe një vit Kopshtin e fëmijëve. Sipas nevojës atyre u ipet ndihmë e shtuar.

### *Klasët e vogëla B apo shkollimi special*

Disa fëmijë përcaktohen drejtëpërsdrejti në klasët e vogëla B apo në shkolla speciale (psh. Shkolla për fëmijtë me të meta gjuhësore).

## **Bashkëpunimi**

Edukatoret e Kopshtit të fëmijëve përkujdesen për një kontakt të rregullt me juve dhe ju informojnë me kohë për gjendjen e fëmiut të juaj dhe në përgjithësi për shkollimin. Nganjëherë vendimi për formën reale të shkollimit nuk është i thjeshtë. Edukatoret e Kopshtit të fëmijëve e marrin me seriozitet vlerësimin e fëmiut dhe parashtrojnë të vërejturit e tyre. Në raste të veçanta mund të ndodhë, që edhe pas bisedave intenzi-ve dhe spjegimeve, nuk vjen deri të pëlqimi i dyanshëm. Këtu vendos Kuvendi i shkollës pasi t' i dëgjoj pjesëmarrësit. Vendimi definitiv për fillimin e shkollimit merret më së voni tri javë para përfundimit të vitit shkollor. Në qoftë se keni pyetje lidhur me shkollimin apo aftësitë shkollore të fëmiut të juaj, kërkoni me kohë bisedë me edukatoren e Kopshtit të fëmijëve apo me personat tjerë profesional.

Ne ju dëshirojmë juve dhe fëmiut të juaj një fillim të mirë në një fazë të re të jetës.